IAAP "Abdyl Ramaj" Shirokë

Nr. Protokolli: 158/2026

Datë: 21.09.2026

Në bazë të Rregullores së shkollës, kodit etik dhe veshjes për nxënës dhe sipas Vendimit të KDSH të mbajtur më datë 16.09.2026, Drejtoria e shkollës e bënë këtë:

FTESË PËR OFERTË

Pas vendimit të marrë nga Këshilli Drejtues i Shkollës, ftojmë operatorët ekonomik, të cilët merren me konfeksionin e veshjes, uniformave shkollore, të marrin pjesë në ofertën për konfeksionimin (qepjen) e uniformës shkollore për nxënës të klasave të X-ta dhe atë:

1. Për femra dhe meshkuj, bluzë me mëngë të shkurta të modelit standard me ngjyrë të bardhë në sasi prej rreth 230 copë;
2. Për femra dhe meshkuj, duks me mëngë të gjata të modelit standard me ngjyrë hiri në sasi prej rreth 230 copë;

Operatorët Ekonomik që aplikojnë duhet t`i plotësojnë këto kushte:

1. Të ofrojë certifikatën e regjistrimit të biznesit, licenca për të drejtën e zhvillimit të veprimtarisë;
2. Vërtetimi për shlyerjen e obligimeve tatimore ndaj ATK-së jo më të vjetër se 90 ditë;
3. Formulari i paraqitjes së ofertës, merret në Drejtorinë e shkollës IAAP "Abdyl Ramaj";
4. Me rastin e hapjes së Ofertës të prezantojnë nga një mostër konfeksioni;
5. Në uniformë (bluzë dhe duks) duhet të jetë e shtypur logo dhe emri i shkollës;

Fituesi i ofertës do të zgjidhet Operatori Ekonomik, i cili i plotëson të gjitha kriteret e mësipërme, ka kualitetin dhe ofertën me çmimin më të ulët, vlerësuar nga komisioni i emëruar nga KDSH.

- Afati i shprehjes se interesit dhe terheqja e Formularit për paraqitje të ofertës, merret në Drejtorinë e shkollës IAAP "Abdyl Ramaj" në Shirokë, duke filluar nga data: 23.09.2026, prej orës 08:00 deri 14:00;
- Afati i dorezimit te ofertave është 7 ditë pune nga dita e publikimit, përkatësisht deri me datë 01.10.2026, ora: 13:30, në sekretarinë e IAPP "Abdyl Ramaj" në Shirokë.
- Hapja e ofertave bëhet në prani të Operatorëve Ekonomik nga komisioni i emëruar nga KDSH, në Sallën e Arsimtarëve më datë 01.01.2026, në ora 14:00.

Shirokë, Suharekë

Drejtori i shkollës: *Destan Berisha*

CamScanner